

REPUBLIKA E KOSOVES / REPUBLIKA KOSOVA /
 REPUBLIC OF KOSOVO
 QEVERIA - VLADA - GOVERNMENT
 MINISTRIA E EKONOMISE
 MINISTARSTVO EKONOMIJE
 MINISTRY OF ECONOMY

Njësia Org. 01/3 Nr. Prof. 1018
 Org. Jedin Br. Prof.
 Org Unit Prof.No.
 Nr. i faqëve Datum: 29.05.26
 Broj stranica Date:
 No. pages PRISHTINE:A NO.1

REGIONALNA AGENCIA ZA VODOOPSKREVANJE
 »HIDROREGJIONI JUGOR« SH.A.D.

Nr. 3075
 Dt. 28.05 2026
 PRIZREN



KRU **Hidroregjioni Jugor** sh.a. Prizren

Adresa: Wesley Clark p.n., 20000 Prizren
 email: sh.a-hidroregjionijugor-prizren@hotmail.com

Bordi i Drejtorëve në K.R.U "Hidroregjioni Jugor" SH.A me seli në Prizren, në përputhje me nenin 31 (31.2) të Ligjit për Ndërmarrjet Publike Nr.03/L-087 për raportet tremujore dhe nenin 18 Ligjit Nr.04/L-111 Ligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr.03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, në mbledhjen e mbajtur me datë 28.05.2026, mori këtë:

VENDIM

RAPORTI – TM1 - 2026

Bordi i Drejtorëve miratoi raportin e TM1 për vitin 2026 në mbledhjen e mbajtur me datë 28.05.2026.

	Delegoi	Aprovoi
Emri Mbiemri	Kryeshef Ekzekutiv Bekim Gashi	Kryesuesi i BD Ylber Elshani
Nënshkrimi		
Data	28.05.2026	28.05.2026




1998



KRU **Hidroregjioni Jugor** sh.a. Prizren

Adresa: Wesley Clark p.n., 20000 Prizren
email: sh.a-hidroregjionijugor-prizren@hotmail.com



RAPORT – TM1 2026


TM1 – 2026 -KRU "HIDROREGJIONI JUGOR" SH.A. – PRIZREN

Përmbajtje

ZONA E PËRGJEGJËSISË SË SHËRBIMEVE	3
I. AKTIVITETET E KRYESHEFIT EKZEKUTIV	4
1.1 Aktivitetet kryesore	4
1.2 Të arriturat kryesore	5
1.3 Problemet që kanë ndikuar ne realizimin e objektivave	6
1.4 Masat e propozuara	6
2 DEPARTAMENTI I UJIT TË PIJES	7
2.1 Situata e furnizimit	7
2.2 Aktivitetet kryesore	8
2.3 Aktivitetet për zvogëlimin e UPF-së – TM1- 2026	9
2.4 Cilësia e ujit të pijes	9
3 DEPARTAMENTI KOMERCIAL	14
3.1 Aktivitetet kryesore	14
3.1.2 Inspektimi dhe Shkyçja	17
4 DEPARTAMENTI I FINANCAVE	17
4.1 Aktivitetet kryesore	17
4.2.1 Arsyeshmëria e shpenzimeve	18
5 DEPARTAMENTI I UJËRAVE TË NDOTURA	20
4.1 Aktivitetet e përgjithshme	20
VI. DEPARTAMENTI I ADMINISTRATËS	24
6.1 Aktivitetet kryesore	24
VII. PERFORMANCAT OPERATIVE DHE FINANCIARE	31
7.1 NJ.P- PRIZREN – TM1- 2026	31
7.2 NJ.P- SUHAREKË – TM1- 2026	32

7.3	NJ.P- DRAGASH – TM1- 2026.....	33
7.4	NJ.P- MALISHEVË – TM1- 2026.....	34
7.4	KRU „HIDROREGJIONI JUGOR” Sh.A– TM1- 2026	35
7.4	REALIZIMI I CAQEVE - KRU „HIDROREGJIONI JUGOR” -TM1- 2025-2026.....	36
VIII.	AKTIVITETET E PROKURIMIT	37
IX.	MENAXHIMI E RREZIQEVE.....	38
X.	ORGANOGRAMI.....	41

ZONA E PËRGJEGJËSISË SË SHËRBIMEVE



I. AKTIVITETET E KRYESHEFIT EKZEKUTIV

1.1 Aktivitetet kryesore

- Takimet e rregullta ditore, javore e mujore, të menaxhmentit.
- Takimet me institucionet komunale, qeveritare, institucione financiare donatore, operatorët ekonomik, me konsumatorë, palë tjera të interes, etj.
- Monitorimi dhe menaxhimi profesional i stacioneve e sistemeve elektropompuese dhe shërbimeve e furnizimeve për mirëmbajtjen dhe operimin e tyre.
- Pergaditja e projekteve per inicim dhe implementim, sipas plan-biznesit 2026.
- Vazhdimi i punimeve në projektin: “Studimi i fizibilitetit për furnizim me ujë të pijës për Komunën e Malishevës”.
- Fillimi i punimeve ne projektin “Rehabilitimi i rrjetit të ujesjellesit dhe vendosja e ujematesve jashte prones private në rr.Kenan Halimi” dhe rruget dytesore ne Suhareke.
- Inicimi i projektit “Rehabilitimi i rrjetit te ujesjellesit ne rrugen Hamit Thaqi-Prizren.
- Inicimi i projektit; Furnizimi, instalimi i aparaturave te klorinimit,
- Shtimi i masave te sigurise, vizita ne burimet e ujit dhe raportimi per gjendjen e burimeve.
- Rregullimi dhe servisimi i pompës 90kw, në njësinë e Malishevës me qëllim të shtimit të kapacitetit prodhues dhe paranadlimin e problemeve me furnizim.
- Përcaktimi i 6-DMA zonave në njësitë punuese Prizren, Suharekë dhe Mlishevë.
- Percaktimi dhe vendosja e leshuesve ne sistemin furnizues, me qellim te pastrimit te rrjetit ne rastet kur paraqiten turbullira. Ne fokus njesia e Malisheves.
- Dergimi i te dhenave per projektin “Resilienca Klimatike ne sektorin e Ujit ne Kosove”.
- Takim me WRIPS, shkembim i informatave dhe te dhenave.
- Takim ne ME, shpalosja e projekteve per aplikim ne WBIF.
- Takim ne kryetarin e komunes se Mamushes.
- Takim me përfaqësues të KK-Prizren dhe OE, për projektin “Hartimi i projektit detal për rritjen e kapacitetit të ujit duke shfrytëzuar burimet Vërmicë dhe Poslisht”.
- Vendosja e gypave Ø110mm dhe Ø63mm, baj-pas për furnizimin e rezervuarit “Tusuz” dhe fashatit “Pouskë”. Probleme të furnizimit të shkaktuara si rezultat i rrëshqitjes së dheut.
- Pergaditja e projekt-propozimeve, per dergim ne institucione qeveritare (ME, MI, etj).
- Takim ne ARRU, diskutim rreth situates se furnizimit dhe cilesise se ujit, me fokus ne njesine e Malisheves.
- Zgjidhja e Problemeve me kapërderdhjen e rezervuarëve, për shkak të dështimit të sistemit komunikues.
- Monitorim i implementimit te platformes per Operim dhe Mirembajtje MMS.
- Implementimi i “Plani i Veprimit per UPF 2025”.
- Takime me KK dhe Institucione me qellim të arketimin e borgjeve ndaj KRU-se

1.2 Të arriturat kryesore

TM1 - 2026

- Shkyçje të lidhjeve ilegale: 143
- Shkyçje për mos pagesë: 1.081
- Shkyçje totale: 1.224
- Përmbaues: 153
- Riprogramim i borgjit: 35
- Njoftime paralajmëruese: 9.912
- Bllombime te reja: 756

TM1 -2025- 2026

- Prodhimi - m3 për - 1.62% (- 131,857 m3)
- Faturimi - m3 për + 0.51 % (+9,492 m3)
- Faturimi - € për +32.73% (+442,517.17 €)
- Arkëtimit -€ për +24.81% (+328,850.76€)
- Arkëtimi ne % - -5.4% (nga 98.2% në 92.8%)
- Shpenzimeve- € për +25.29% (+315,363.66 €)
- Rryma elektrike- € për +63.89% (+171,815.23 €)
- Pagat- € për +18.07% (+141,297.53 €)
- UPF- -0.5% (76.5%)
- Mbulimi operativ- € +17.3% (nga +78,680.05€ në +92,267.15€)

REALIZIMI I CAQEVE TM1-2026

- Prodhimi - m3 për 98.38%
- Faturimi - m3 - 93.53%
- Faturimi - € - 88.70%
- Arkëtimit -€ - 81.09%
- Arkëtimi ne % - 94.32%
- Shpenzimeve- €- 122.51%
- UPF- 98.40%
- Mbulimi operativ- € (nga +24,044.51€ në +92,267.15€)

1.3 Problemet që kanë ndikuar ne realizimin e objektivave

- Humbje të konsiderueshme të ujit për shkak të amortizimit të rrjetit dhe defekteve të shpeshta në gypat primarë e sekundarë.
- Probleme me cilësinë e ujit në disa burime si rezultat i reshjeve me intensitet të lartë të cilat kanë ndikuar me turbullirë dhe përqendrim të lartë të manganit.
- Pastrimi i sistemit të furnizimit me ujë për të parandaluar depërtimin dhe përhapjen e ujit të turbullt në rrjet, i cili mund të rrezikojë cilësinë dhe sigurinë e ujit të pijshëm.
- Pastrim i rezervuarëve të ujit, pas paraqitje së turbullirës, veçanërisht në njësin e Malishevës.
- Mungesë e automjeteve dhe veglave të nevojshme për ekipet teknike, duke vështirësuar mirëmbajtjen dhe reagimin në kohë.
- Probleme me tensionin e ulët të energjisë elektrike, që ndikon negativisht në funksionimin e pompave dhe stacioneve të furnizimit.
- Kapërderdhje e rezervuarëve për shkak të dështimit të sistemit telekomunikues, i cili ka ndodhur si rezultat i ndërprerjeve të shpeshta të energjisë elektrike.
- Rënie e efikasitetit operative, për shkak të kushteve jo të favorshme klimatike.
- Numër i madh ujëmatësish të dëmtuar ose të pa pllombuara dhe mungesë e një ekipi të specializuar (nëpër njësi) për ndërrimin dhe mirëmbajtjen e tyre.
- Ujëmatësit e prodhimit defekt si dhe ato zonal, shumica problem për çasje.
- Mungesë e mbështetjes nga komunat për projekte infrastrukturore dhe koordinim të dobët ndërinstitucional.
- Përdorim në nivel të ulët të web-aplikacionit MMS nga njësitë (Suharekë, Malishevë dhe Dragash).
- Numri i madhe i konsumatorëve pa konsum. (Shtëpi dhe banesa të pa banuara)
- Numri i madhe i ujëmatësve me te vjetër se pese vite.
- Rastet sociale
- Muaji i ramazanit

1.4 Masat e propozuara

- Riorganizimi i shërbimit të operativës
- Rritja e efikasitetit të punës
- Zbatim i planit të veprimit për zvoglimin e UPF-se
- Zbatimi i plotei MMS-sit
- Formimi i DMA zonave të reja
- Perfundimi i projekteve kapitale
- Perfundimi i projektit për objektin e klorinimit.
- Funkcionalizimi i plotei të qendrës së thirrjeve (24 ore)
- Vazhdimi i bllombimit të ujëmatësve.
- Rifreskimi i të dhënave të konsumatorëve.

- Identifikimi dhe dorëzimi i faturave tek konsumatorët edhe në formë elektronike.
- Përgatitja e draft projekteve me prioritet, rehabilitimin e burimeve ekzistuese dhe zvogëlimin e humbjeve teknike
- Rritje e bashkëpunimit me KK
- Përgatitja e projekteve për eficient të energjisë
- Rritja e aktiviteteve të shërbimit të ndërrimit të ujëmatësve
- Rritja e aktiviteteve në shkyçjen e konsumatorëve ilegal, shkyçjeve për mos pagesë dhe dërgimit të rasteve tek përmbauesit privat

2 DEPARTAMENTI I UJIT TË PIJES

2.1 Situata e furnizimit

Furnizimi i konsumatorëve me ujë të pijshëm për muajt Janar-Mars 2026, në nivel regional dhe në të gjitha njësitë punuese e operuese, ka qenë i rregullt, pasi që janë ndërprerë aplikimi i reduktimeve në zona të ndryshme. Kjo situatë ka lindur si rezultat i rritjes së nivelit të ujit nëpër burime dhe anagazhimi i sitafit në menaxhimin e defekteve në sitemin furnizues.

Në krahasim me muajt paraprak, furnizimi në muajt Janar-Mars 2026, ka qenë i qëndrueshëm mirëpo vlenë të theksohet se ndërprerjet e shpeshta të energjisë elektrike kanë ndikuar negativisht në përmbushjen e standardeve optimale të furnizimit 24-orësh me ujë të pijshëm në disa zona. Krahas aktiviteteve të vazhdueshme dhe masave të ndërmarra, si shfrytëzimin e gjeneratorëve si dhe në operim, mirëmbajtje dhe monitorim intensiv të sistemit të ujësjellësit, kemi arritur të sigurojmë furnizim të qëndrueshëm me ujë. Në njësinë e Malishevës niveli i turbullirës ka qenë prezent, dhe pas intervenimit me vendosjen e leshuesve të ri në rrjetin primar, ky problem është zgjidhur. Si rezultat i këtyre aktiviteteve është rikthyer furnizimi i rregullt me ujë dhe në cilësi për pije.

Reduktimet dhe mungesat e furnizimit me ujë nuk ka pasur në tërësi në zonën e shërbimit. Kompania vazhdon të ndërmarrë masa për modernizimin dhe përmirësimin e infrastrukturës hidroteknike dhe elektro-mekanike, duke synuar sigurimin e një furnizimi të qëndrueshëm dhe cilësor të ujit për të gjithë konsumatorët në zonën e mbulueshmërisë.

Përpjekjet për investime kapitale janë intensifikuar, duke synuar zgjidhjen e qëndrueshme dhe afatgjatë të problemeve teknike dhe infrastrukturës së vjetër, si dhe menaxhimin efikas të burimeve ujore në kushtet aktuale klimatike.

NJ.P – Prizren

**Furnizimi me ujë:* Ka qenë i qëndrueshëm, furnizim 24/7, në krahasim me muajt paraprak si rezultat i rritjes së nivelit të ujit në burimet kryesore. Reduktimet janë eliminuar në tërësi, të cilat janë aplikuar në disa lagje të qytetit të Prizrenit si dhe në fshatin Zhur si zonë e vetme periferike. Si rezultat i rrëshqitjes së dheut dhe dëmtimit të gypt furnizues janë paraqitur probleme me rënie të presion në lagjen “Hoqamahallë” e cila furnizohet nga burimi “Cvilen”.

NJ.P- Suharekë

Gjatë muajve Janar-Mars 2026, furnizimi me ujë ka qenë i qëndrueshëm, ndërprerje të ujit kemi pasur vetëm gjatë intervenimit në rregullimin e defekteve në rrjetin e ujësjellësit. Vetëm në fshatin Samadraxhë kemi pasur reduktime të ujit për arsye të energjisë elektrike që ka qenë e dobët.

NJ.P - Malishevë

* Gjatë tremujorit të parë (TM1), furnizimi me ujë në njësinë tonë ka pasur luhajtje, me probleme më të theksuara në muajin janar dhe përmirësim gradual në muajt shkurt dhe mars. Në janar, vështirësitë kanë qenë kryesisht si pasojë e reshjeve dhe vërshimeve, të cilat kanë shkaktuar turbullira të mëdha dhe kanë detyruar shkarkimin e ujit në lumë për periudha të gjata. Burimet më të afektuara kanë qenë në Banjë, Gurbardh dhe Bubël, ndërsa probleme janë paraqitur edhe në zona të tjera të shërbimit.

Në shkurt dhe mars, furnizimi ka qenë përgjithësisht më i qëndrueshëm, por turbullirat pas reshjeve kanë vazhduar të paraqesin sfida, duke kërkuar ndërhyrje të shpeshta për pastrimin dhe shkarkimin e rrjetit. Janë realizuar disa ndërhyrje teknike, përfshirë instalimin e një elektropompe dhe vendosjen e shkarkuesve shtesë, të cilat kanë ndikuar në përmirësimin e cilësisë dhe stabilitetit të furnizimit.

Megjithatë, pikat e larta kanë vazhduar të kenë probleme të furnizimit gjatë gjithë tremujorit, kryesisht për shkak të rënies së presionit dhe mosfunksionimit të qëndrueshëm të elektropompës 90 kW nr. 2. Si pasojë, disa lagje në Banjë, Malishevë dhe Carralluk, veçanërisht ato në lartësi më të madhe, kanë mbetur të afektuara. Pavarësisht këtyre sfidave, ndërhyrjet në rrjet dhe sanimet e defekteve kanë ndikuar në përmirësimin gradual të furnizimit drejt fundit të tremujorit.

NJ.P - Dragash

* Gjatë muajve Janar-Mars, 2026, furnizimi me ujë ka qenë i rregullt, këtë situatë stabile e kanë mundësuar aktivitetet të cilat kanë ndodhur, fillimisht me sigurimin e mjaftueshëm të ujit për trajtim, pastrimin e pusetave, eliminimin e defekteve në gypat e ujësjellësit, dhe punë të tjera (pastrime) në kaptazhë në fshatin Radeshë.

2.2 Aktivitetet kryesore

Mirëmbajtja e rrjetit – Sanimi i defekteve / TM1- 2026

Njësia Operative	Ujësjetësi - uji i pijes
Prizren	435
Suharekë	73
Dragash	20
Malishevë	57
Total	585

Ndërrimi i ujëmatësve- detektimi / TM1- 2026

Aktivitetet/Grupet - e menaxhuar nga Departamenti i Ujit të Pijes (DUP)		
Grupet	Aktivitetet e grupeve gjatë muajve Janar-Mars, 2026	
Kalibrim i ujëmatësve	36	riparime të ujëmatësve
Ndërrimi i ujëmatësve (D-M)	475	vizita të konsumatorët
	316	ndërrime të ujëmatësve
	96	riparim të defekteve gjatë ndërrimit
Detektimit të rrjetit	199	detektive
	137	defekte të gjetura
	15,480	rrjet i detektuar (m)

2.3 Aktivitetet për zvogëlimin e UPF-së – TM1- 2026

UPF, në aspektin teknik dhe komercial, vazhdon të mbetet një ndër sfidat kryesore të Kompanisë.

Departamenti i ujit të pijes me të gjithë sektoret në përgjithësi dhe me divizionin e UPF-së në veçanti është duke bërë përpjekje konsistente për të evidentuar dhe dixhitalizuar infrastrukturën ekzistuese, mbarëvajtjen e realizimit të projekteve investive në harmoni me mundësitë buxhetore dhe sanimin në kohë optimale dhe efikase të prishjeve, rrjedhjeve të pakontrolluara, keqpërdorimeve dhe dëmtimeve tjera të mundshme në rrjetë. DUP përkatësisht divizioni për UPF, bazuar në Strategjinë për zvogëlimin e humbjeve të ujit për periudhën kohore 2024-2026, në vazhdimësi kryen aktivitete të përfshira edhe në planin e veprimit për periudhën e paraparë të vitit 2025.

Në kuadër të zbatimit të Planit të Veprimit për zvogëlimin e Ujit Pa Faturim (UPF) për vitin 2026, gjatë muajit Prill 2026 janë zhvilluar aktivitete të ndryshme në teren për kontrollin e rrjetit, verifikimin e konsumatorëve dhe përditësimin e të dhënave në disa zonat matëse (DMA).

1) DMA - Kobaj

Ekipa e Kontrollës gjatë muajit Prill ka vazhdura aktivitetet në DMA-Kobaj

Ekipa e Kontrollës gjatë muajit Prill 2026 ka vazhduar aktivitetet në DMA-Kobaj. Janë inspektuar 120 konsumatorë, të cilëve u janë përditësuar të dhënat dhe me secilin konsumator janë nënshkruar kontratat e shërbimeve. Gjatë këtyre inspektimeve janë identifikuar edhe 8 lidhje ilegale.

2) DMA – Maxharr

Në DMA-Maxharrë, gjatë muajit Prill 2026 janë verifikuar 125 konsumatorë. Gjatë inspektimeve janë identifikuar 2 ujëmatës jo-funksional, 43 raste me mbi lexim, si dhe 35 raste me nën-lexim, 2 puseta të mbuluara pa qasje në ujëmatës

3) DMA – Dragobil

Në DMA-Dragobil, gjatë muajit Prill 2026 janë verifikuar 79 konsumatorë. Gjatë inspektimeve janë identifikuar 2 ujëmatës jo-funksional, 79 raste me mbi lexim, si dhe 35 raste me nën-lexim 9 puseta të mbuluara pa qasje në ujëmatës

4) DMA- Shkozë

Në DMA-Shkozë, gjatë muajit Prill 2026 janë verifikuar 56 konsumatorë. Gjatë inspektimeve janë identifikuar 2 ujëmatës jo-funksional, 50 raste me mbi lexim 16 puseta të mbuluara pa qasje në ujëmatës

Pas inspektimeve të realizuara në zonat e DMA-ve (Dragobil, Maxharrë dhe Shkozë), vlerësohet e domosdoshme vazhdimi i aktiviteteve operative, me fokus në ndërrimin e ujëmatësave jo-funksional, zbulimin dhe hapjen e pusetave të mbyllura.

Po ashtu, gjatë muajit Prill janë inspektuar edhe objektet fetare në Komunën e Malishevës, në fshatrat nën menaxhimin e KRU-së, ku është konstatuar se:

- Disa xhami janë të regjistruara dhe nën lexim (Malishevë, Banjë, Gurbardhë),
- Disa objekte janë të kyçura në rrjetin e ujësjellësit pa ujëmatës dhe pa faturim (Karvansaraj, Lumishtë),
- Edhe varrezat në Mirushë dhe Banjë rezultojnë të kyçura pa ujëmatës dhe pa faturim.

5) DMA-Sallagrazhdë

Pas përfundimit të inspektimeve në teren nga ekipa e kontrollës gjatë muajit paraprak, janë identifikuar 61 konsumatorë të cilët kanë probleme me ujëmatësit. Sipas leximeve dhe verifikimeve në databazë për tre muajt e fundit këta ujëmatës nuk regjistrojnë shpenzime edhe pse uji përdoret, ndërsa gjendja nuk ka ndryshuar.

Propozohet që të bëhet zëvendësimi i këtyre ujëmatësve.

Aktivitet e tjera

- Takim lidhur me projektin: *Rezilienca Klimatike në Sektorin e Ujit të Kosovës (Rezilienca Klimatike) për DMA-Sallagrazhdë*

Konkluzione nga takimi:

Duke u bazuar në gjetjet nga inspektimi i kryer, u dakordua që në vijim të zbatimit të planit për zvogëlimin e humbjeve të ujit në këtë DMA Sallagrazhdë, ekipet e KRU Hidroregjioni Jugor, me mbështetjen e Ekipit të Projektit, të ndërmarrin veprimet në vijim:

- të zëvendësohen të gjithë ujëmatësit jofunksionalë, si dhe ata më të vjetër se 10 vite, në përputhje me Planin e Kompanisë për Zvogëlimin e Humbjeve të Ujit për këtë DMA;
- të testohen ujëmatësit më të vjetër se 5 vite në laboratorin e KRU Hidroregjioni Jugor dhe, sipas nevojës, të kalibrohen; rezultatet e kalibrimin do të shërbejnë edhe për llogaritjen e bilancit ujqor të Kompanisë;
- të pllombohen të gjithë ujëmatësit e konsumatorëve;

- (iv) të instalohen manometra në pikat specifike në DMA, përkatësisht pas ujëmatësit zonal dhe në pjesët më të ulëta të zonës;
- (v) të sigurohet një ujëmatës portativ për kryerjen e matjeve që do të verifikojnë saktësinë e ujëmatësit kryesor (ujëmatësit zonal), si dhe për matje dhe analiza në degët e rrjetit;
- (vi) të fillohet me aktivitetet për detektimin dhe riparimin e rrjedhjeve në DMA me pajisjen e re të blerë së voni nga Kompania.

Treguesit kryesor të Performancës së DMA-ve

2b	Zona e përzgjedhur (DMA) - Dardani		Janar	Shkurt	Mars	Prill
	Uji që hyn në zonë (DMA)	m ³	54,661	38,880	104,887	82,073
	Uji i faturuar	m ³	10,071.00	6,075.00	7,373.00	6,720.00
	i matur	m ³	10,071.00	6,075.00	7,373.00	6,720.00
	i pa matur	m ³	0.00	0.00	0.00	0.00
	Konsumi i ujit që nuk faturohet (objekt kult, shesh, park)	m ³	0.00	0.00	0.00	0.00
	Uji i pa-faturuar	m ³	44,590.00	32,805.00	97,514.00	75,353.00
	Faturim mesatar për konsumator aktiv	m ³	30.99	11.62	20.31	18.98
	Përqindja e ujit të pafaturuar	%	82%	84%	93%	92%

2b	Zona e përzgjedhur (DMA) - Kobaj		Janar	Shkurt	Mars	Prill
	Uji që hyn në zonë (DMA)	m ³	11,580	11,580	11,580	11,580
	Uji i faturuar	m ³	2,768.00	2,464.00	2,612.00	2,997.00
	i matur	m ³	2,768.00	2,465.00	2,612.00	2,997.00
	i pa matur	m ³	0.00	0.00	0.00	0.00
	Konsumi i ujit që nuk faturohet (objekt kult, shesh, park)	m ³	30.00	7.00	310.00	21.00
	Uji i pa-faturuar	m ³	8,782.00	9,109.00	8,658.00	8,562.00
	Faturim mesatar për konsumator aktiv	m ³	14.72	13.46	14.43	15.21
	Përqindja e ujit të pafaturuar	%	76%	79%	75%	74%

2b	Zona e përzgjedhur (DMA) -Sallagrazhdë	Muaji	Janar	Shkurt	Mars	Prill
	Uji që hyn në zonë (DMA)	m ³	16,119	13,092	12,819	12,951
	Uji i faturuar	m ³	2,796	1,777	1,607	2,165
	i matur	m ³	2,796	1,777	1,607	2,167.00

i pa matur	m ³	0	0	0	0
Konsumi i ujit që nuk faturohet (objekt kult, shesh, park)	m ³	0	0	0	0
Uji i pa-faturuar	m ³	13,323	11,315	11,212	10,786
Faturim mesatar për konsumator aktiv	m ³	18.16	15.59	15.45	20.23
Përqindja e ujit të pafaturuar	%	82.65%	86.43%	87.46%	83.28%

2b	Zona e përzgjedhur (DMA) -Nëperbishtë		Janar	Shkurt	Mars	Prill
	Uji që hyn në zonë (DMA)	m ³	2,000	1,765	1,966	2,073
	Uji i faturuar	m ³	1,507	1,008	1,519	1,674
	i matur	m ³	1,507	1,008	1,519	1,674
	i pa matur	m ³	0	0	0	0.00
	Konsumi i ujit që nuk faturohet (objekt kult, shesh, park)	m ³	0	0	0	0.00
	Uji i pa-faturuar	m ³	493.0	757.0	447.0	399.0
	Faturim mesatar për konsumator aktiv	m ³	17.52	13.62	13.81	19.02
	Përqindja e ujit të pafaturuar	%	24.65%	42.89%	22.74%	19.25%

2b	Zona e përzgjedhur (DMA) -Shkozë		Janar	Shkurt	Mars	Prill
	Uji që hyn në zonë (DMA)	m ³	129	501	780	883
	Uji i faturuar	m ³	86	217	212	111
	i matur	m ³	86	217	212	11
	i pa matur	m ³	0.00	0.00	0.00	0.00
	Konsumi i ujit që nuk faturohet (objekt kult, shesh, park)	m ³	0.00	0.00	0.00	0.00
	Uji i pa-faturuar	m ³	43.00	284.00	568.00	772.00
	Faturim mesatar për konsumator aktiv	m ³	1.51	15.50	16.31	7.40
	Përqindja e ujit të pafaturuar	%	33%	57%	73%	87%

2b	Zona e përzgje (DMA) -Dragobil-Maxharrë		Janar	Shkurt	Mars	Prill
	Uji që hyn në zonë (DMA)	m ³	5,890	8,110	8,050	7,150
	Uji i faturuar	m ³	623.00	486.00	6,914.0	645.00
	i matur	m ³	623.00	486.00	6,914.0	645.00
	i pa matur	m ³	0.00	0.00	0.00	00
	Konsumi i ujit që nuk faturohet (objekt kult, shesh, park)	m ³	0.00	0.00	0.00	0.00
	Uji i pa-faturuar	m ³	5,267.00	7,624.00	1,136.00	6,505.00
	Faturim mesatar për konsumator aktiv	m ³	3.07	6.31	123.46	10.57
	Përqindja e ujit të pafaturuar	%	89%	94%	14%	91%

2.4 Cilësia e ujit të pijes

- Kontrolli permanent i prezencës së klorit residual në kroje në Qytet ,si dhe kontrollimi i klorit në fshatra.
- Kontrolli permanent i kualitetit të ujit në burime si dhe të puseve të cilat shfrytëzohen për momentin.
- Kontrolli i rregullt i stacioneve të klorinimit per te percjellur punen e procesit të klorinimit dhe paisjeve.
- Marrja e mostrave sipas Planit per monitorim te cilesis se ujit.
- Në Malishevë pasë intervenimeve të bëra në rrjetë vazhduan kontrollet e shpeshta per cilesin e ujit .
- Furnizim i stacioneve të klorinimit me Hipoklorit të Natriumit në të gjitha fshatrat.

Analizat bakteriologjike dhe fiziko-kimike nga : IKSHP - PRIZREN -TM1- 2026

NJËSIA	LLOJI I UJIT	NR. I MOSTRAVE	NUK I PËRGJIGJEN
PRIZREN	Burim	0	0
	Ujësjiellës	432	1
DRAGASH	Burim	0	0
	Ujësjiellës	26	0
SUHAREKË	Burim	0	0
	Ujësjiellës	62	1
MALISHEVË	Burim	0	0
	Ujësjiellës	229	40
KRU	Burim	0	0
	Ujësjiellës	749	42

* Mostrat te cilat nuk I pergjigjen standardit per Konsum Human janë si rrezultat te vershimeve te cilat ndodhën në fillim të vitit ku erdhi deri te depërtimi I ujrave sipërfaqësor ne burime dhe ne rrjetë kryesishtë në Mlishevë.(prezente ishte Turbullira dhe Mangani).

LABORATORI – KRU

KRU Hidroregjioni Jugor	TM-1	Lloji furnizimit	Mostra Totali	Bakterologjike			Fiziko-Kimike		
				Nr. Mostrave	Përgjigjet	Nuk përgjigjet	Nr. Mostrave	Përgjigjet	Nuk përgjigjet
	Janar 2025	Burim	56	30	4	26	26	21	5
Rrjet		156	81	68	13	75	60	15	
Shkurt 2025	Burim	44	22	3	19	22	22	0	

	Rrjet	178	89	89	0	89	77	12
Mars 2025	Burim	84	42	12	30	42	38	4
	Rrjet	180	90	90	0	90	81	9
Totali	Burim	184	94	19	75	90	81	9
	Rrjet	514	260	247	13	254	218	36

3 DEPARTAMENTI KOMERCIAL

3.1 Aktivitetet kryesore

Gjatë TM1 2026, kompania ka shënuar performancë pozitive në shumicën e treguesve kryesorë. Numri i faturave dhe të hyrat kanë pësuar rritje të dukshme, ndërsa konsumi i ujit (m³) ka mbetur relativisht stabil. Kjo tregon një përmirësim në efikasitetin e faturimit dhe arkëtimit.

Megjithatë, gjatë kësaj periudhe kompania është ballafaquar me probleme në furnizim, kryesisht gjatë muajit janar, kur reshjet me intensitet të lartë kanë shkaktuar turbullira në burimet nëntokësore. Për këtë arsye, kompania ka qenë e detyruar të lëshojë njoftime se uji nuk ishte i përdorshëm për pije, gjë që ka ndikuar në uljen dhe kufizimin e konsumit nga ana e konsumatorëve.

Gjithashtu, gjatë TM1 ka përkuar edhe muaji i shenjtë i Ramazanit, periudhë gjatë së cilës konsumi i ujit dhe pagesat e faturave kanë qenë më të vështira për konsumatorët. Gjatë kësaj periudhe vërehet një performancë pozitive në disa indikatorë kyç të operimit, veçanërisht në rritjen e faturimit dhe inkasimit.

Faturimi i Ujit (m³)

Faturimi i ujit në m³ për TM1 2026 ka arritur në 1,885,058 m³ krahasuar me 1,875,566 m³ në TM1 2025, duke shënuar një rritje prej vetëm 9,492 m³ ose 0.51%.

Kjo rritje minimale tregon se **konsumi real i ujit ka mbetur pothuajse i pandryshuar**, duke reflektuar stabilitet në kërkesën për ujë nga konsumatorët. Ndryshimi kaq i vogël mund të lidhet me faktorë si kushtet klimatike të ngjashme ndërmjet periudhave, mungesa e

zgjërimeve të mëdha në rrjet, apo edhe një nivel i qëndrueshëm i aktivitetit ekonomik dhe familjar.

Konsumi total mbetet pothuajse i pandryshuar.. Megjithatë, duhet theksuar se nga 1 janari 2026 ka hyrë në fuqi ndryshimi i tarifave të shërbimit, sipas vendimit nr. 923/D, datë 31.12.2025, të Autoritetit Rregullativ për Shërbimet e Ujit. Si rezultat i rritjes së tarifave, konsumatorët kanë filluar të adoptojnë sjellje më racionale në përdorimin e ujit, duke ndikuar në mbajtjen nën kontroll të konsumit, veçanërisht në sektorin shtëpiak.

Faturimi i Ujit (€)

Faturimi nga uji (€) ka shënuar një rritje të konsiderueshme nga 1,345,043.32 € në TM1 2025 në 1,731,740.66 € në TM1 2026, pra një rritje prej 386,697.34 € ose 28.75%.

Kjo rritje është dukshëm më e lartë sesa rritja e faturimit në m³ (vetëm 0.51%), çka tregon qartë se rritja e të hyrave nuk vjen nga konsumi, por nga faktorë të tjerë financiarë. Arsyet janë:

- Rritja e tarifave të ujit, e cila ka ndikuar drejtpërdrejt në vlerën e faturimit.
- Strukturë më e favorshme e konsumit, p.sh. rritje e konsumit nga kategori me tarifa më të larta (biznese).

Faturimi – të tjera (€) ka pësuar një rritje jashtëzakonisht të lartë nga 6,920.91 € në TM1 2025 në 62,740.74 € në TM1 2026, pra një rritje prej 55,819.83 € ose 806.54%.

Rritja e faturimit – të tjera (€) të lidhet drejtpërdrejt me ndryshimin e çmimit të kyçjeve të reja dhe aplikimin e tarifës së mbi-ngarkesave në infrastrukturë, të cilat zakonisht reflektohen në këtë kategori.

Inkasimi nga uji (€)

Inkasimi nga uji (€) ka shënuar rritje nga 1,320,732.99 € në TM1 2025 në 1,606,826.57 € në TM1 2026, pra një rritje prej 286,093.58 € ose 21.66%.

Kjo është një zhvillim pozitiv pasi tregon se kompania ka arritur të arkëtojë më shumë të hyra nga konsumatorët gjithashtu edhe rritja e tarifave nga janari 2026 ka ndikuar në një arkëtim më të qëndrueshëm.

Inkasimi – të tjera

Inkasimi – të tjera (€) ka shënuar një rritje shumë të lartë nga 4,996.51 € në TM1 2025 në 48,049.86 € në TM1 2026, pra një rritje prej 43,053.35 € ose 861.67%.

Kjo rritje është në linjë me rritjen e **faturimit – të tjera**, duke treguar se një pjesë e madhe e këtyre të hyrave jo standarde jo vetëm që janë faturuar, por edhe janë **inkasuar me sukses**. Kjo sugjeron një performancë të mirë në arkëtimin e zërave si:

- tarifa për kyçje të reja
- mbi-ngarkesa infrastrukture

Inkasimi total (€)

Inkasimi total është rritur nga 1,325,729.50 € në TM1 2025 në 1,654,876.43 € në TM1 2026, duke shënuar një rritje prej 329,146.93 € ose 24.83%.

Rritja e përgjithshme e inkasimit reflekton përmirësim në performancën e arkëtimit, përfshirë rritjen e tarifave nga janari 2026 dhe aplikimin e tarifave të reja.

% e inkasimit

% e inkasimit ka rënë nga 98.2% në TM1 2025 në 92.8% në TM1 2026, pra një ulje prej 5.4 pikë përqindje.

Kjo është edhe si rezultat rritjes së faturimit . Me fjalë të tjera, një pjesë më e madhe e faturave të lëshuara nuk është inkasuar brenda periudhës.

TM1 2026 paraqet një periudhë të karakterizuar nga:

- ndryshim tarifor strukturor (efekt i menjëhershëm në faturim)
- presion socio-ekonomik mbi konsumatorët (kosto familjare + Ramazan)
- ngadalësim i përkohshëm i inkasimit

Pra, rënia e % së inkasimit nuk duhet interpretuar si përkeqësim i performancës operative, por si efekt i kombinuar i rritjes së çmimeve dhe faktorëve sezonalë/socialë.

3.1.1 Ankesat teknike dhe komerciale

- Janë shqyrtuar të gjitha ankesat teknike ndërsa ankesat komerciale të konsumatorëve janë shqyrtuar sipas kohës dhe prioritetit të tyre

TM1-2026

1. Ankesat Teknike për Shërbimet e Ujit dhe Kanalizimit	numër	531
1.1 Rrjedhje e ujit	numër	420
1.2 Mungese e ujit	numër	68
1.3 Rënie e presionit	numër	20
1.4 Cilësia e ujit	numër	2
1.5 Të tjera	numër	21
2. Ankesat Komerciale për Shërbimet e Ujit dhe Kanalizimit	numër	216
2.1 Kontestim i borxhit, fatures	numër	152
2.2 Verifikim i leximit të ujematesit /te tjera	numër	52
2.3 Te tjera	numer	12

3.1.2 Inspektimi dhe Shkyçja

Me intensitet të shtuar , kanë vazhduar kontrollet në teren nga ekipi i inspektimit tek konsumatorët, legalizim te konsumatorëve, ankesa te konsumatorëve, inkasim e borgjeve dhe aktivitete të tjera.

RAPORT I EKIPEVE TË INPEKTORIATIT – TM1- 2026

Njesite operative	Dergimi i verejtjeve	Konsumatorët e legalizuar/regjistruar	Lidhjet e paligjshme të zbuluara	Nr. i shkyçjeve dhe mos pages	Verifikimi i leximit të ujëmatësve	Lexime të gabuara	Rastet e dorezuar prokuror i/permbarim	Vizita nga ankesat/kerkesat konsumatoreve	Riprogramimi	Bllom bime
Prizren	5,367	732	78	654	2,422	28	101	228	17	692
Suharek	3,635	91	60	558	3,976	14	24	36	3	-
Malishev	640	50	5	12	283	18	28	36	14	51
Dragash	-	7	-	-	15	-	-	1	1	13
HRJ	9,912	880	143	1,224	6,689	60	153	301	35	756

4 DEPARTAMENTI I FINANCAVE

4.1 Aktivitetet kryesore

Ky raport përfshinë të gjitha aktivitetet nga shërbimi financiar në pika të shkurtra, aktivitete të cilat janë konform rregullores së punës së kompanisë si dhe ligjeve në fuqi. Duke u nisur nga regjistrimet e rregullta dhe të drejta sipas ligjeve në Kosovë e deri te aktivitetet tjera për një performacë sa më të mirë të kompanisë.

- Regjistrimet e komisioneve të arkave, inventarit si dhe atij të depos dhe pranimit e raporteve të tyre;
- Punët ditore të zakonshme, si regjistrimi i arkave në bazë ditore, regjistrimet furnitorëve, depove si dhe aseteve për muajt përkatës.
- Përgatitja e raporteve mujore e tre muajore për institucionet përkatëse, si ARRU, ASK, ME etj.
- Hapja dhe përgatitja e pagave për muajt përkatës, kontrollim, barazim dhe verifikim të regjistrit të punësuarve.
- Raportet ditore nga shërbimi i arkës, gjendjen e arkës në lidhje me inkasimet ditore, ato të amvisërisë, bizneseve, gjendjen e llogarive bankare, kontimin e tyre, barazimet etj;
- Pranimi, kontrollimi dhe nënshkrimi i kërkesave për blerje, aprovimi i tyre për blerje dhe shpërndarja e materialit të blerë;

- Kontrollimi dhe pranimi i faturave për blerjet si dhe regjistrimi i tyre në kontabilitet, pas kontrollimeve;
- Barazimet e rregullta të arkave mobile me dorëzimin e mjeteve në bankë apo arken kryesore;
- Barazimet e rregullta të furnitorëve, pagesat e rregullta, sipas blerjeve;
- Regjistrimi i investimeve kapitale si dhe raportimi i tyre;
- Regjistrimet ditore në kontabilitet të hyrje/daljeve të materialit në depo;
- Plotësimin e librit të blerjes dhe shitjes sipas kërkesës nga ATK, për muajin përkatës;
- Deklarimet e tatimeve, TVSH-së, tatimet e pagave etj, sipas ligjeve në fuqi;
- Përgatitjen e Draft Pasqyrave Financiare për vitin 2025;
- Takimet e rregullta me menaxhmentin e kompanisë, lidhur me performancën dhe prezantimin e rekomandimeve për aktivitete të tjera për performancë më të mirë të kompanisë;

4.2.1 Arsyeshmëria e shpenzimeve

Shpenzimet operative të ndërmarrjes për tre mujorin e I-ë 2026, në krahasim me shpenzimet e tremujorit të IV-të 2025 janë për 12 % më të ulëta;

Më poshtë do t'i cekim disa nga pozicionet, të cilat kanë lëvizur më së shumti dhe arsyet e rritjes apo rënies së tyre;

Në pozicionin e pagave nuk kemi ndonjë ndryshim të tyre në krahasim tremujorin e kaluar që vlen të theksohet;

Ndërsa te pozicioni i energjisë elektrike, kemi një rënie të dukshëm të shpenzimeve për këtë tremujor, për shkak se në këtë tremujor, përveç çmimit më të ulët të energjisë elektrike, kemi edhe konsum më të ulët për shkak se nevoja e pompave për nxjerrjen e ujit nga burimet ka qenë shumë më e ulët si rrjedhojë e ujit të mjaftueshëm në vendburime;

Gjithashtu rënie kemi edhe te shpenzimet e derivateve në krahasim me tremujorin e kaluar, për shkak se aktivitetet për riparime dhe mirëmbajtje të rrjetit kanë qenë më të vogla, kjo edhe ka ndikuar në rënie të shpenzimeve të kësaj kategorie;

Rënie kemi tek pozicioni i mirëmbajtjes dhe riparimeve, dhe mirëmbajtjes së pompave, në krahasim me muajin e kaluar. Këto shpenzime varen krejt nga numri i defekteve që mund të ndodhin në rrjetin e ujësjellësit;

Gjithashtu rënie kemi edhe tek shpenzimet e pozicionit të mirëmbajtjes së automjeteve. Duhet pasur parasysh se në këtë mes të tremujorit, është nënshkruar kontrata për mirëmbajtje të automjeteve dhe kjo ka ndikuar që këtë shpenzime të jenë më të ulëta ani pse nevoja për riparime ka qenë e lartë, siç është parë edhe në muajin mars;

Ndërsa rritje të lehtë kemi pasur te shpenzimet e taksave, për shkak se në këtë tremujor, kemi pasur më shumë lëndë të dërguara tek përmbaruesi, ndërsa shpenzimet e tjera jo pse kanë ndryshuar shumë, si ato të SHUKOS dhe të ARRU-së;

Te shpenzimet e kategorisë të tjera, kemi rënie të shpenzimeve, pra në këtë kategori ku përfshihen shpenzimet administrative, shpenzimet të jashtme profesionale, siç janë shpenzimet për mirëmbajtje të softuerit, mirëmbajtje për GPS, shpenzimet e provizioneve, gjithashtu këtu hyjnë edhe shpenzimet për veshmbathje të punëtorëve operativë;

Pra si përfundim, shpenzimet totale, për këtë tremujor kanë qenë më të ulëta në krahasim me tremujorin e kaluar, për arsytet e cekura më lartë.

10 pagesat me te medha nga Hidroregjioni Jugor per Operatoret TM1 2026

NR.	DATA	Document No.	OPERATORI	SHUMA -C
1	2/2/2026	BPBPZNPOS-011826	KORPORATA ENERGETIKE E KOSOVES	214,083.44
2	2/25/2026	BPBPZNPOS-011916	KORPORATA ENERGETIKE E KOSOVES	184,418.77
3	3/31/2026	BPBPZNPOS-012059	KORPORATA ENERGETIKE E KOSOVES	117,410.21
4	1/16/2026	TEB-SH-000006283	GENERAL Holding L.L.C	22,133.00
5	3/31/2026	TEB-SH-000006874	Xerxa Hidro Goup	17,700.00
6	3/9/2026	TEB-SH-000006681	Xerxa Hidro Goup	15,393.60
7	3/19/2026	TEB-SH-000006796	GENERAL Holding L.L.C	14,786.65
8	1/6/2026	TEB-SH-000006211	KEK - Vërmicë	10,063.84
9	2/9/2026	TEB-SH-000006458	KEK - Vërmicë	10,063.84
10	3/5/2026	TEB-SH-000006663	KEK - Vërmicë	10,063.84
				616,117.19

10 pagesat me te medha ndaj Hidroregjioni Jugor per TM1 2026

NR	DATA	EMRI I KONSUMATORIT	BANKA	KATEGORIA	SHUMA
1	27.03.2026	Qendra Medicinale SPITALI	Banka per Bisnes	INSTITUCIO	67,438.49
2	27.03.2026	SPITALI I QARKUT HEMODIALIZA	Banka per Bisnes	INSTITUCIO	9,449.32
3	30.03.2026	Sh.f.m.u "Lekë Dukagjini"	Banka per Bisnes	BIZNESE	7,668.68
4	31.03.2026	Sh.m.I mjekësisë "Luciano Motroni"	Banka per Bisnes	LOKALET	5,989.40
5	31.03.2026	Sh.m.I Gjinnazi "Gjon Buzuku"	Banka per Bisnes	LOKALET	5,727.33
6	16.03.2026	K.KOMUNAL (Fontana)	Banka per Bisnes	INSTITUCIO	4,891.23
7	19.02.2026	Sh.M"Jetimat e Ballkanit"-Gjinoc	Banka Ekonomike	SHTEPI..Q	3,725.15
8	27.01.2026	Fatime Nuhi Rashiti	Teb Banka	INSTITUCIO	2,457.08
9	27.03.2026	Qendra Per Pun Sociale	Banka per Bisnes	SHTEPI..Q	2,165.53
10	12.02.2026	Shtepia e Sh.Ambulanca.S	Banka per Bisnes	INSTITUCIO	2,055.29

111,567.50

5 DEPARTAMENTI I UJËRAVE TË NDOTURA

4.1 Aktivitetet e përgjithshme

- Angazhim dhe menaxhim i përditshëm i aktiviteteve që kanë të bëjnë me operim, funksionim dhe optimizim të ITUN-se në Prizren dhe aktivitete të vazhdueshme për konsolidim të Departamentit të Ujërave të Ndotura,
- Takimet e rregullta të menaxhmentit, takimet virtuale me donatore të huaj dhe vendor, me institucionet komunale, qeveritare, me konsumator, me konsulencat e projektit dhe me kontraktoret etj.,
- Shkëmbimet e shkresave përmes komunikimeve elektronike e fizike, harmonizimi i aktiviteteve për ITUN-ne aktuale dhe projektet tjera potenciale të cilat mund të përfitohen në të ardhmen në këtë sektor,
- Angazhimi si kryetar i komisionit për projektin Rehabilitimi i sistemit të kanalizimit në qytetin e Prizrenit Faza V dhe VI, përmes korrespondencave të vazhdueshme me konsulencën e projektit dhe KfW-ne si agjencion financues i këtij projekti,
- Monitorimi, krahasimi dhe aplikimi i testeve të analizave në laboratorin e ITUN-se,
- Takime të rregullta mujore me stafin aktual të ITUN-se,
- Procedimi i kërkesave logjistike dhe atyre investive për nevojat e ITUN-se,
- Vizite në punishte gjatë realizimit të projekteve në baza ditore-Inspektimi i punimeve dhe koordinimi i aktiviteteve,
- Takim i rregullt mujor me konsulencën SPR&Hidrorring dhe kontraktorin Alb Star, me temën Progresi i punimeve për projektin “Rehabilitimi i rrjetit të kanalizimit për qytetin e Prizrenit” Faza V dhe VI

OPERIMI I I.T.U.N - SË PËR PERIUdhËN TM1- 2026

Uji i trajtuar m³ për TM1-2026

Muaji	Uji në hyrje m ³ /muaj	Uji ricirkuluar- m ³ /muaj	Uji i trajtuar (m ³ /muaj)
Janar	318,056	91,823	335,606
Shkurt	340,816	95,196	361,895
Mars	369,181	98,302	390,167
Total	1,028,053	285,321	1,087,668

Koment : Ndryshimi në mes të ujit të ndotur në hyrje dhe në dalje sipas sistemit SCADA me të cilin matet në mënyrë automatike, lejohet deri në 5.0%, në rastin të një ndryshimi është 5.0%

Stabilizimi i llumit m3 per TM1-2026

Muaji	Llumi pompuar nga sedimentuesi primar m3/muaj	Llumi pompuar nga sedimentuesi sekondar- m3/muaj	Llumi i deponuar ne shtreter (m3/muaj)
Janar	379	433	9
Shkurt	418	264	0
Mars	501	270	51
Total	1,298	967	60

Mirëmbajtja e planifikuar sipas aplikacionit MMS per TM1-2026

Muaji	Trajtimi Mekanik	Trajtimi Biologjik	Trajtimi I Llumit
Janar	199	187	208
Shkurt	215	198	202
Mars	190	185	202
Total	604	570	612

Mirëmbajtja emergjente sipas aplikacionit MMS per TM1-2026

